



VETERANËT E UÇK-SË PROTESTOJNË PARA KUVENDIT KUNDËR EKSPOZITËS SKANDALOZE
"MASAKRAT NË KOSOVË 1998-1999" | FAQE 4-5

NËSE S'KA REFLEKTIM INSTITUCIONAL, PROTESTAT KUNDËR EKSPOZITËS SKANDALOZE DO TË VAZHDOJNË



"Jo me paratë tona kundër nesh", "Mos luani me sakrificën tonë", "Stop shtrembërimit të historisë!", kanë qenë vetëm disa nga pankartat që protestuesit kanë mbajtur në duar në protestën e djeshme e cila është organizuar nga OVLUÇK-ja në Prishtinë kundër ekspozitës skandaloze me titull

"Masakrat në Kosovë 1998-1999". Përfaqësuesi i OVLUÇK-së, Xhavit Jashari, ka hedhur dyshime se informacionet për ekspozitën e Shkëlzen Gashit janë marrë nga shërbimet sekrete serbe. Ndërsa ish-ushtarja e UÇK-së, Aida Dërguti, ka thënë se nuk do të lejojnë të poshtërohen dhe

nëpërkëmben viktimat civile. Pas përfundimit të protestës, OVLUÇK-ja ka njoftuar se nëse nuk do të ketë refleksim nga ana e institucioneve ndaj kërkesave të saj, "aktiviteti ynë kundër tendencave për shtrembërimin e historisë sonë do të vazhdojë edhe në ditët në vijim"

OPINION

UÇK-ja DHE FILOZOFIA E DINJITETIT F. 6

Shkruan:
Ethem ÇEKU



ALIBIA E KRIMIT F. 7

Shkruan:
Hajdin ABAZI



AKTUALE



MIRATOHET PROJEKTIGJI PËR BYRONË DHE KONFISKIMIN E PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME F. 3

PEZULLOHEN NGA PUNA DY INSPEKTORË DHE ZYRTARI PËRGJEGJËS PËR PUNISHTEN NË RRUGËN "DON SHTJEFËN KURTI" F. 6

QEVERIA MIRATON PROJEKTIGJIN PËR BANIMIN SOCIAL DHE TË PËRBALLUESHËM F. 6

SPORT



KOSOVA LUAN SONTE KUNDËR TURQISË PËR LAVDI DHE HISTORI F. 11



OPOZITA FAJËSON LV-NË PËR ÇËSHTJEN E PRESIDENTIT, PARTIA NË PUSHTET SHPRESON NË NJË MARRËVESHJE F. 7



QEVERIA MIRATON PROPOZIMIN PËR DËRGIMIN E FSK-së NË GAZA, VENDIMI I KALON KUVENDIT F. 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Spanja mbyll hapësirën ajrore për operacione në luftën kundër Iranit

MADRID, 30 MARS - Qeveria e Spanjës ka vendosur ta mbyllë hapësirën ajrore për avionët që marrin pjesë në një operacion ushtarak kundër Iranit, kryer nga ShBA-ja dhe Izraeli. Duke cituar burime ushtarake, raporti i publikuar nga “El País” ka theksuar se Madridi zyrtar jo vetëm që nuk po lejon përdorimin e bazave ajrore

strategjike në Rota (Cádiz) dhe Morón de la Frontera (Sevilje), por ka refuzuar planet e fluturimit për avionët amerikanë të vendosur në vende të treta si Mbretëria e Bashkuar dhe Franca. Operacioni ushtarak, i njohur si “Epic Fury”, ka shkaktuar reagime të forta politike në Evropë, ndërsa Spanja ka



zgjedhur një qëndrim të prerë kundërshtues ndaj përfshirjes në të. Kryeministri Pedro Sanchez e ka bërë të qartë pozicionin e qeverisë gjatë një fjalimi në parlament, duke e cilësuar ndërhyrjen si “luftë të paligjshme”. Ai ka theksuar se të gjitha kërkesat që lidhen me operacionin janë refuzuar,

përfshirë edhe ato për furnizimin me karburant të avionëve ushtarakë. Sipas deklaratës së tij, autoritetet spanjolle kanë bllokuar çdo plan fluturimi që lidhet me veprime ushtarake në Iran, duke përfshirë edhe përdorimin e hapësirës ajrore për tranzit apo mbështetje logjistike.

TRUMPI: DUAM NAFTËN E IRANIT, MUND TA PUSHTOJMË ISHULLIN KHARG

WASHINGTON, 30 MARS - Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund ta marrin naftën në Iran dhe, ndoshta, ta pushtojnë ishullin Kharg. Nëpër këtë territor kalon rreth 90 për qind e naftës së Iranit që më pas transportohet në botë. “Për të qenë i sigurtë, gjëja ime e pëlqyer është ta marr naftën në Iran, por disa njerëz budallenj në ShBA thonë: ‘Pse po e bën këtë?’”. Ndoshta e marrim ishullin Kharg, ndoshta jo. Kemi shumë mundësi”, ka thënë Trumpi. Komentet e presidentit vijnë ndërsa 3 500 trupa të tjera amerikane mbërritën në Lindjen e Mesme, ndërsa frika rritet se përshkallëzimi i mëtejshëm mund t’i ekspozojë forcat amerikane ndaj sulmeve iraniane. Trumpi ka theksuar se bisedimet indirekte midis

amerikanëve dhe Iranit nëpërmjet ndërmjetësve pakistanezë po përparojnë mirë, por nuk pranoi të komentonte nëse një marrëveshje armëpushimi mund të arrihej së shpejti. Duke folur në “Air Force One”, ai ka thënë se Irani ishte gati ta dorëzonte uraniumin dhe, nëse jo, nuk do të ekzistojë më si vend. Kreu i Shtëpisë së Bardhë ka theksuar se Shtetet e Bashkuara besojnë se kanë arritur ndryshim regjimi në Iran, pasi liderët janë vrarë. Ndërsa në një postim të shkurtër në platformën e tij sociale, presidenti Trump ka thënë se Shtetet e Bashkuara kanë shkatërruar tashmë “shumë objektiva” në Iran. Javën e kaluar Komanda qendrore amerikane ka thënë se ushtria kishte goditur më shumë se 9 000 objektiva në të gjithë vendin.



ZELENSKY NË JORDANI SYNON TA FORCOJË MBËSHTETJEN NGA VENDET E GJIRIT



AMMAN, 30 MARS - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ndodhet për vizitë zyrtare në Jordani në kuadër të një turneu në vendet e Gjirit. Zelensky është duke synuar forcimin e lidhjeve mbrojtëse dhe sigurimin e mbështetjes së re për Ukrainën. Vizita vjen në një moment të ndjeshëm gjeopolitik, teksa tensionet në rajon janë rritur për shkak të zhvillimeve që lidhen me Iranin. Në këtë kontekst, Zelensky

është duke u përpjekur ta zgjerojë bashkëpunimin me fuqitë rajonale dhe të sigurojë mbështetje financiare dhe ushtarake. Udhëheqësi ukrainas është duke tentuar t’i bindë shtetet e Gjirit të kontribuojnë në përpjekjet e Ukrainës për t’u përballur me agresionin rus, në një kohë kur ndihma ushtarake nga partnerët perëndimorë mbetet e pasigurt. Përveç aspektit ushtarak, Kievi është duke u

përballur edhe me sfida ekonomike. Në këtë drejtim është duke tentuar ta mbulojë deficitin buxhetor dhe ta financojë prodhimin vendas të armëve, si pjesë e strategjisë për ta rritur vetëmjaftueshmërinë në mbrojtje. Ky turne pritet të përfshijë takime me liderë rajonalë, me fokus në bashkëpunimin strategjik dhe mbështetjen afatgjatë për Ukrainën.

Australia përgjysmon taksën e karburantit për tre muaj për t’i frenuar çmimet

CANBERRA, 30 MARS - Qeveria australiane do t’i përgjysmojë taksat e karburantit për tre muaj për t’i ndihmuar shoferët e goditur nga çmimet në rritje të benzinës, ka njoftuar kryeministri Anthony Albanese. Taksa aktualisht 52 cent për litër, do të përgjysmohet përkohësisht në një veprim që vlerësohet se do t’i kushtojë qeverisë rreth 1.75 miliardë

dollarë australianë. “Ne po ulim kostot e karburantit sot sepse e kuptojmë se australianët janë nën presion të madh”, ka thënë Albanese, duke theksuar nevojën për veprim të menjëhershëm. Rritja e çmimeve tashmë po ndihet: në Uellsin e Ri Jugor, çmimi mesatar i benzinës është rritur nga 1.82 dollar australianë në 2.48 dollarë

australianë për litër vetëm në pak javë, ndërsa nafta ka arritur në 3 dollarë australianë. Qeveria australiane është duke u përpjekur ta qetësojë tregun, duke theksuar se importet e karburantit janë duke vazhduar normalisht dhe se problemet në disa zona janë kryesisht për shkak të mosfunksionimeve të blerjeve dhe shpërndarjes në panik.



QEVERIA MIRATON PROPOZIMIN PËR DËRGIMIN E FSK-SË NË GAZA, VENDIMI I KALON KUVENDIT

PRISHTINË, 30 MARS - Qeveria e Kosovës ka miratuar propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes për dërgimin e trupave të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Gaza, duke hapur rrugë procedimit të vendimit për miratim në Kuvendin e Kosovës. Sipas legjislacionit në fuqi, pas vendimit të ekzekutivit, çështja u kalon ligjvënësve për shqyrtim dhe votim, ndërsa në fund kërkohet edhe miratimi i presidentit të vendit.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë mbledhjes së qeverisë ka thënë se “jemi të gatshëm të marrim pjesë dhe ta ndihmojmë popullin e Gazës, sepse edhe vetë kemi qenë dhe jemi përfitues të forcave ndërkombëtare që nga viti 1999”.

Ndërsa ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka thënë se përmes këtij angazhimi Kosova synon të dëshmojë se është partnere e besueshme dhe e gatshme të veprojë krah aleatëve në mbështetje të paqes dhe sigurisë. “Ky vendim forcon edhe më tej profilin ndërkombëtar të shtetit tonë, afirmon profesionalizmin e FSK-së dhe e vendos republikën tonë në radhën e shteteve që jo vetëm përfitojnë nga siguria ndërkombëtare, por edhe kontribuojnë vazhdimisht në ruajtjen e paqes dhe rendit ndërkombëtar”, ka thënë ai.

Vendimi për dërgimin e trupave të FSK-së në Gaza është miratuar pa

asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim. Dërgimi i trupave të FSK-së parashihet të bëhet në kuadër të Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese (FNS), një mekanizëm i krijuar si pjesë e nismës së ashtuquajtur Bordi i Paqes, i propozuar nga presidenti amerikan Donald Trump për arritjen e paqes në botë.

Kosova është në mesin e pesë shteteve të para, së bashku me Indonezinë, Marokun, Kazakistanin dhe Shqipërinë, që janë zotuar për angazhim në këtë mision, me qëllim ofrimin e sigurisë dhe mbikëqyrjen e armëpushimit në Rripin e Gazës. Megjithatë, ende nuk dihet se kur saktësisht do të ndodhë dislokimi i trupave dhe sa do të jetë numri i tyre. Ministria e Mbrojtjes ka bërë me dije më herët se propozimvendimi për këtë çështje ishte përcjellë në qeveri më 3 mars.

Vendimi i qeverisë vjen pasi funksionalizimi i punës së Kuvendit, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese më 25 mars, ka hapur rrugën për trajtimin e çështjeve të tilla.

Përveç autorizimit për dërgimin e trupave, Kuvendi duhet ta miratojë edhe marrëveshjen për anëtarësimin e Kosovës në Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka qenë ndër themelueset e Bordit të Paqes, e ka mbështetur publikisht këtë nismë. Mandati i saj presidencial



përfundon më 4 prill. Sipas raportimeve të transmetuesit publik izraelit KAN, Forca Ndërkombëtare Stabilizuese pritet të nisë angazhimin në Gaza nga muaji maj, përfshirë edhe dhjetëra ushtarë nga Kosova, megjithëse institucionet në Prishtinë nuk e kanë konfirmuar zyrtarisht këtë afat.

Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka deklaruar se fillimisht planifikohet dërgimi i mbi 20 ushtarëve të specializuar në fusha të ndryshme, përfshirë njësitë për deminim dhe eliminim të mjeteve të pashpërthyer (EOD), operacione speciale,

planifikim dhe ekupe mjekësore. Zyrtarët e ministrisë kanë bërë me dije se janë në koordinim të vazhdueshëm me strukturat e FNS-së dhe se është caktuar edhe një ushtarak ndërlidhës për përgatitjen e dislokimit. Forca Ndërkombëtare Stabilizuese pritet të ketë për detyrë stabilizimin e situatës së sigurisë në Gaza, pas luftës që nisi në tetor të vitit 2023, kur Hamasi, i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian, kishte sulmuar Izraelin dhe vrarë mbi 1 200 njerëz dhe duke marrë pengje. Sulmet pasuese izraelite në Gaza kanë shkaktuar dhjetëra

mijëra viktima, krizë humanitare dhe dëme të mëdha infrastrukturore. Plani për krijimin e kësaj force është pjesë e një pakoje më të gjerë për arritjen e paqes, e cila është pranuar nga palët në konflikt. Kjo nuk do të ishte hera e parë që FSK-ja dislokohet jashtë vendit. Më 2021 ajo mori pjesë në një mision në Kuvajt në bashkëpunim me forcat amerikane, ndërsa më 2022 në Ishujt Falkland, në bashkëpunim me Mbretërinë e Bashkuar. FSK-ja është aktualisht në proces të shndërrimit në ushtri të plotë, proces që pritet të përfundojë deri në vitin 2028.

MIRATOHET PROJEKTLIGJI PËR BYRONË DHE KONFISKIMIN E PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME

PRISHTINË, 30 MARS - Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar të hënën Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, i propozuar nga Ministria e Drejtësisë si një nga nismat kryesore reformuese në kuadër të forcimit të sundimit të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit.

Sipas një njoftimi për medie, bëhet me dije se në fjalën e tij kryeministri Albin Kurti ka thënë se Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme përbën një nga zotimet më të rëndësishme të qeverisë në fushën e drejtësisë. “Angazhimit tonë të madh për jetësimin e Byrosë, fatkeqësisht, ish-pushtetarët iu përgjigjën me kundërshtim e zell të paimagjinueshëm. Jemi sfiduar, por nuk jemi ndalur e as nuk do të ndalemi. Do ta jetësojmë Byronë përkundër atyre që motivet e vërteta i fshehin prapa ankesave në Gjykatën Kushtetuese”, ka thënë kryeministri Kurti.

Ndërsa zëvendëskryeministrja dhe ministria e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka theksuar rëndësinë e këtij ligji për rritjen e



llogaridhënies dhe besimit qytetar në institucione. “Ky ligj jep një mesazh të qartë: Mandati publik nuk është mundësi për pasurim personal, si dhe është përgjegjësi që duhet kryer bazuar në dispozitat dhe obligimet ligjore. Në anën tjetër, për qytetarët kjo nismë dhe ky ligj do të thonë më shumë barazi, pastaj drejtësi dhe, gjithashtu, më

shumë besim në institucionet shtetërore”, ka deklaruar ajo. Ministria Gërvalla ka thënë se ky projektligj është rezultat i një procesi disavjeçar reformash që ka nisur në vitin 2021 dhe është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, duke reflektuar rekomandimet e Komisionit të Venedikut dhe

gjetjet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. “Ky moment shënon edhe fillimin e një rrugëtimi maratonik pothuajse 5-vjeçar drejt jetësimin të kësaj nisme reformuese, e cila, bazuar në analizat dhe hulumtimet paraprake, derivon nga nevoja e shtimit të instrumenteve dhe kompletimit të infrastrukturës ligjore në fushën kundër

korupsionit dhe kundër krimit të organizuar”, është shprehur ministrja Gërvalla.

Projektligji për Byronë Shtetërore, sipas ministres Gërvalla, ka për qëllim ta forcojë llogaridhënien e zyrtarëve publikë, duke e bërë të qartë se pasuria duhet të jetë në përputhje me të ardhurat e ligjshme si dhe t'i ruajë standardet kushtetuese dhe të drejtat themelore, duke siguruar që çdo ndërhyrje në pronë të bëhet vetëm me vendim gjyqësor dhe mbi bazë prove.

Në fund, ministrja Gërvalla ka thënë se miratimi i këtij projektligji konsiderohet hap i rëndësishëm drejt kompletimit të infrastrukturës ligjore në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe drejt rritjes së besimit të qytetarëve në institucionet shtetërore. Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme përfaqëson hap vendimtar në forcimin e sundimit të ligjit dhe luftimin e korrupsionit në Republikën e Kosovës. Ai krijon mekanizëm efektiv për të hetuar dhe konfiskuar pasurinë që nuk mund të arsyetohet me burime të ligjshme duke synuar drejtpërdrejt ata që janë pasuruar në kurriz të qytetarëve.



VETERANËT E UÇK-SË PROTESTOJNË PARA KUVENDIT KUNDËR EKSPOZITËS SKANDALOZE
“MASAKRAT NË KOSOVË 1998-1999”

NËSE S’KA REFLEKTIM INSTITUCIONAL, PROTESTAT KUNDËR EKSPOZITËS SKANDALOZE DO TË VAZHDOJNË

“Jo me paratë tona kundër nesh”, “Mos luani me sakrificën tonë”, “Stop shtrembërimit të historisë!”, kanë qenë vetëm disa nga pankartat që protestuesit kanë mbajtur në duar në protestën e djeshme e cila është organizuar nga OVLUÇK-ja në Prishtinë kundër ekspozitës skandaloze me titull “Masakrat në Kosovë 1998-1999”. Përfaqësuesi i OVLUÇK-së, Xhavit Jashari, ka hedhur dyshime se informacionet për ekspozitën e Shkëlzen Gashit janë marrë nga shërbimet sekrete serbe. Ndërsa ish-ushtarja e UÇK-së, Aida Dërguti, ka thënë se nuk do të lejojnë të poshtërohen dhe nëpërkëmben viktimat civile. Pas përfundimit të protestës, OVLUÇK-ja ka njoftuar se nëse nuk do të ketë reflektim nga ana e institucioneve ndaj kërkesave të saj, “aktiviteti ynë kundër tendencave për shtrembërimin e historisë sonë do të vazhdojë edhe në ditët në vijim”

EPOKA E RE **Lirim GECI**

PRISHTINË, 30 MARS - Organizata e Veteranëve Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka mbajtur të hënën një protestë para Kuvendit të Kosovës kundër ekspozitës skandaloze për masakrat në Kosovë e cila është organizuar nga organizatat joqeveritare “Integra” dhe “Admovere”, me autor Shkëlzen Gashin. “Jo me paratë tona kundër nesh”, “Mos luani me sakrificën tonë”, “Stop shtrembërimit të historisë!”, kanë qenë vetëm disa nga

pankartat e protestuesve para Kuvendit të Kosovës. Në shenjë frustrimi, protestuesit kanë hedhur ngjyrë para dymve të Kuvendit, institucionit që e ka mbështetur financiarisht ekspozitën. Xhavit Jashari, përfaqësues i shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, ka thënë se ka dyshime se informacionet për ekspozitën e Shkëlzen Gashit, ish-këshilltar i kryeministrit Albin Kurti, janë marrë nga Serbia. “Ne vlerësojmë veprimin e komunës së Prishtinës që largoi këto eksponate për të cilat dyshojmë

se informacionet janë marrë nga shërbimet sekrete serbe. Dyshimet tona janë se kanë bashkëpunuar me këto institucione të cilat, përpjekjet i kanë bërë për ta barazuar luftën tonë me atë që ka bërë ushtria serbe në Kosovë”, ka thënë Jashari. Sipas tij, brenda qeverisë Kurti ka ministra që janë kundër UÇK-së. “Degradimi kaq i rëndë dhe i paskajshëm i kësaj qeverie vjen sepse brenda saj ka ministra të cilët janë anti-UÇK. Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka deklaruar publikisht se më mirë dhe më lirë do të na kushtonte liria e këtij vendi po t’i kishim paguar mercenarët, që është fyerje e rëndë për veteranët”, ka theksuar Jashari. Pas përfundimit të protestës, OVLUÇK-ja i ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit, duke paralajmëruar se nëse kërkesat e tyre nuk merren për bazë, atëherë aktivitetet e tyre do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim. “Falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit në protestën simbolike të sotme, të organizuar nga kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së. Njëherësh, njoftojmë opinionin publik se nëse nuk do të ketë reflektim nga ana e institucioneve ndaj kërkesave

tona, aktiviteti ynë kundër tendencave për shtrembërimin e historisë sonë do të vazhdojë edhe në ditët në vijim, për të cilat do të njoftoheni me kohë”, ka njoftuar OVLUÇK-ja.

Dërguti: Nuk do të lejojmë të poshtërohen dhe nëpërkëmben viktimat e luftës

Ish-ushtarja e UÇK-së, Aida Dërguti, ka marrë pjesë në protestën e organizuar nga veteranët e UÇK-së kundër ekspozitës për krimet serbe, duke thënë se nuk do të lejojnë të poshtërohen dhe nëpërkëmben viktimat civile. Sipas saj, autorët e kësaj ekspozite, siç e ka quajtur ajo, “shfrenuese”, duhet të mbajnë përgjegjësi. “Veteranë, ndihemi jashtëzakonisht keq që gjatë luftës nuk patëm kapacitete të mjaftueshme të mbrojmë gjithë popullatën civile. Mirëpo sot nuk do të lejojmë të poshtërohen e nëpërkëmben viktimat civile nga kushdo që në kohën e luftës ishte larg ngjarjeve të luftës e masakrave, ndërsa sot përdor referenca nga Serbia. Autorët e këtij shfrenimi mbajnë përgjegjësi direkte bashkë me aktorët politikë që e

mundësuan atë. Barabartë, njësoj mbi çdo zyrtar që përdori fonde publike për të financuar një përmbajtje të tillë. Dhe kjo përbën një skandal të vërtetë. Institucionet shtetërore kanë detyrim ta mbrojnë historinë e jo ta subvencionojnë poshtërimin e saj”, ka thënë Dërguti. Ajo ka kërkuar llogaridhënie institucionale nga të gjithë për, siç ka thënë, zyrtarët që financuan ose miratuan këtë ekspozitë. “Prandaj, kërkojmë llogaridhënie institucionale nga të gjithë zyrtarët që financuan ose miratuan këtë ekspozitë. Institucionet e drejtësisë do të shqyrtojnë pa vonesë veprimet e iniciatorëve. Po ashtu, kërkojmë urgjentisht tërheqjen e botimeve të autorëve nga hapësirat publike dhe pikat e shitjes deri në përfundimin e procesit të llogaridhënies. Gjithashtu, çdo libër apo ngjarje që ka të bëjë me luftën nuk guxon të sponsorizohet e as të shpërndahet nga institucionet e vendit pa kaluar nëpër filtrat e Institutit të Historisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Asnjë organ shtetëror nuk ka të drejtë ta ofendojë luftën. Lavdi dëshmorëve dhe martirëve, gjaku i të cilëve u bë vullë e lirisë”, ka thënë Dërguti.



Kurti: Ekspozita për krimet në Kosovë të korrigjohet dhe të rikthehet e vërteta e plotë në qershor

Para protestës në lidhje me ekspozitën ka reaguar edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Ai ka theksuar nevojën që kjo ekspozitë të korrigjohet dhe të rikthehet në një formë më të saktë dhe gjithëpërfshirëse. Ai ka thënë se dokumentimi dhe prezantimi i saktë i krimeve të luftës është thelbësor jo vetëm për opinionin ndërkombëtar, por edhe për shoqërinë, veçanërisht për gjeneratat e reja që nuk e kanë përjetuar luftën. Sipas tij, një pjesë e madhe e popullsisë ose kanë qenë fëmijë gjatë luftës, ose kanë lindur pas saj, prandaj është e domosdoshme që e vërteta historike të ruhet dhe të paraqitet në mënyrë të drejtë. Kurti ka vlerësuar se një ekspozitë e tillë ka rëndësi të veçantë për të ardhmen e vendit, pasi ndihmon në ruajtjen e kujtesës kolektive dhe në ndërgjegjësimin për çmimin e lartë të lirisë, duke theksuar se shumica e viktimave të luftës në Kosovë

kanë qenë civilë. “Kjo ekspozitë është shumë e rëndësishme për të ardhmen tonë, jo vetëm për të kaluarën tonë. Ndërkaq, është e rëndësishme edhe për aspektin ndërkombëtar, sepse ne dëshirojmë që bota me të cilën kemi ndërveprim të dendur, të mos harrojë asnjëherë se çmimi i lirisë dhe i pavarësisë ishte shumë i lartë dhe në veçanti në popullsinë civile, sepse shumica e të vrarëve në Kosovë janë popullsi civile”, ka thënë Kurti, duke shtuar se një ekspozitë e rishikuar dhe e bazuar në fakte duhet të rikthehet sa më shpejt, duke sugjeruar muajin qershor, në përvjetorin e çlirimit të Kosovës, si një moment i përshtatshëm. “Një ekspozitë e saktë, e drejtë dhe e plotë, mbi të gjitha, e vërtetë për krimet e kryera të Serbisë në Kosovë, besoj se duhet të rikthehet sa më parë. Madje një datë optimale do të ishte qershori, përkatësisht koha kur shënojmë përvjetorin e 27 të çlirimit të Kosovës”, ka thënë Kurti. Ndërsa kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka deklaruar se vendimi për çështjen e ekspozitës është marrë në Kryesinë e Kuvendit, ndërsa përgjegjësia për

përmbajtjen mbetet tek autorët e saj. Ajo ka shprehur keqardhje për situatën e krijuar, duke theksuar se janë prekur familjet dhe qytetarët. “Në raport me çështjen e ekspozitës, më lejoni që në emër të Kryesisë së Kuvendit ta shprehim keqardhjen tonë për atë çfarë ka ndodhur. Ndihe mi shumë keq për të gjitha familjet, palët që janë prekur më së shumti dhe sidomos për qytetarët e republikës së Kosovës. Pas këtij rasti si Kryesi e Kuvendit do të ndërmarrim hapa për ndryshimin e rregullores ekzistuese me qëllim që të formojmë komisione të posaçme profesionale që vlerësojnë kërkesat e tilla sepse rregullorja për subvencionim nuk parasheh një gjë të tillë. Apo në anën tjetër, siç u përmend edhe në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, siç bën sidomos ekzekutivi, ku bëhen thirrje publike paraprakisht e pastaj mbështeten projektet e caktuara nga ana e komisioneve profesionale”, ka thënë ajo. Haxhiu ka thënë se një praktikë e tillë është zbatuar edhe më herët në Ministrinë e Drejtësisë për mbështetjen e projekteve përmes thirrjeve publike dhe vlerësimit profesional. “Për

shembull, sa unë kam qenë ministre e Drejtësisë kështu kemi vepruar, në fillim të vitit është bërë thirrja, kanë aplikuar organizatat me projekte të ndryshme dhe Ministria e Drejtësisë ka mbështetur ato projekte, përkatësisht komisionet profesionale projektet që kanë vlerësuar që lidhen me çështje sociale dhe familjare. Pra, edhe në mbledhjen e Kryesisë së sotme u diskutua si një mundësi e tillë, por pas ndryshimit që do të bëhet në rregulloren ekzistuese. Dua të ritheksoj se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk e ka organizuar ekspozitën. Nën patronatin tim si kryetare e Kuvendit është organizuar vetëm një ekspozitë, ajo më 6 mars. Pra më 6 mars, në 3 ditët e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare”, ka thënë Haxhiu.

Çitaku kërkon hetim për ekspozitën: Kërkimfalja nuk mjafton për pasaktësitë

Nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Vlora Çitaku, ka reaguar lidhur me ekspozitën “Masakrat në Kosovë 1998-1999”, duke

theksuar se një kërkim-falje nuk është e mjaftueshme për gabimet e evidentuara si dhe ka kërkuar hetim të plotë institucional. Sipas saj, pasaktësitë e paraqitura në ekspozitë cenojnë drejtpërdrejt ndjenjat e familjarëve të viktimave dhe dëmtojnë të vërtetën historike për luftën në Kosovë. Ajo ka përmendur në veçanti rastin e masakrës së Dubravës, duke theksuar ndikimin emocional që këto gabime kanë te familjet e prekura. Ndër të tjera, ajo ka kërkuar kthimin e mjeteve të ndara për këtë projekt dhe ka paralajmëruar se rasti nuk duhet të mbyllet pa një hetim të hollësishëm. “Nga pasaktësitë që u panë në ekspozitë, në raste të tilla kërkimfalja nuk mjafton. Unë vetëm mund ta marr me mend se si janë ndierë familjarët e viktimave të masakrës famëkeqe të Dubravës, nëna ime e ka një të vrarë aty. Ka pasur pasaktësi edhe të tjera, por kjo ndikon në narracionin dhe të vërtetën historike. Këtu nuk duhet të përfundojë hetimi. Kërkesa ka ardhur nga organizata ‘Integra’. Kërkesa i është drejtuar kryetares së Kuvendit pastaj ajo e ka ndarë me ne”, ka thënë Çitaku.



Ekspozita skandaloze në shesh: Policia dhe prokuroria i shkojnë në banesë Shkëlzen Gashit

Anëtar i shoqërisë civile, Rron Gjinovci, bashkëpunëtor dhe mik i Shkëlzen Gashit, autorit të ekspozitës me pasaktësi për masakrat e kryera gjatë luftës në Kosovë, ka njoftuar se një njësit policor i Drejtorisë së Krimeve të Rënda ka kryer bastisje në banesën e Gashit me urdhër të Prokurorisë Speciale. Gashi është shoqëruar nga policia për në stacion, megjithëse nuk është

raportuar të jetë arrestuar zyrtarisht. “Ky është njësit i Drejtorisë së Krimeve të Rënda të Policisë, i cili me urdhëresë të Prokurorisë Speciale ndodhet në banesën e Shkëlzen Gashit. Kanë ardhur me bastisje banesën me mbledhë prova dhe me shoqëruar Shkëlzenin, i cili tashmë është nën shoqërimin e policisë, por ende i paarrestuar. Shekulli 21, vend demokratik, Prokuroria Speciale dhe Policia e Krimeve të Rënda bastisin e shoqërojnë njerëz për ekspozitë”, ka shkruar Gjinovci në “Facebook”.

Devijimet dhe shtrembërimet në ekspozitën skandaloze

Organizatat joqeveritare “Integra” dhe “Admovere”, konkretisht autori i ekspozitës për krimet e luftës, Shkëlzen Gashi, ka paraqitur në ekspozitë se mes viktimave kishte edhe “48 shqiptarë të armatosur”, një formulim që ka nxitur reagime të forta. Fondi për të Drejtën Humanitare, ku Gashi u thirr t’i ketë marrë të dhënat, e ka kundërshtuar publikisht këtë pretendim, duke e cilësuar të pasaktë dhe jo profesional.

Në reagimin e tyre është thënë se “kjo nuk është çështje interpretimi, por mungesë elementare e njohurive mbi të drejtën ndërkombëtare humanitare”. Sipas fondit, viktimat në Dubravë ishin të burgosur nën kontroll të plotë të autoriteteve serbe, dhe jo luftëtarë aktivë. Aktivistja serbe Natasha Kandiç ka vënë në dyshim kompetencën profesionale të autorit të ekspozitës. “Shkëlzen Gashi nuk kupton. Ai nuk e kupton dhe as nuk ka dijeni për të kuptuar atë çka ne kemi shënuar”, ka thënë Kandiç. Kandiç ka theksuar se statusi i viktimave ndryshon në

momentin e arrestimit dhe mbrohet nga Konventat e Gjenevës. “Ata janë vrarë si të burgosur nga gardianë të armatosur”, ka thënë ajo, duke kundërshtuar kategorikisht interpretimin e Gashit. Ajo, gjithashtu, ka sqaruar se termi “ushtar” në listime nuk nënkupton automatikisht person të armatosur në momentin e vrasjes. “Ushtar (i listuar) nuk do të thotë shqiptar i armatosur”, ka thënë Kandiç, duke e cilësuar keqlexim të rëndë të të dhënave. Për pasaktësitë skandaloze, Gashi ka kërkuar falje në emër të organizatave joqeveritare “Integra” dhe “Admovere”.



MBROJTJA: ASNJË PROVË KUNDËR THAÇIT, TË LIROHET MENJËHERË

PRISHTINË, 30 MARS - Procesi gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit në Hagë ka hyrë në fazën përfundimtare, pas më shumë se 33 muajsh shqyrtim provash dhe dëgjim të qindra dëshmitarëve. Në dosjen përmbyllëse prej 304 faqesh, mbrojtja e Thaçit ka argumentuar se gjatë gjithë procesit nuk është paraqitur asnjë provë bindëse që do ta vërtetonte përgjegjësinë e tij për akuzat e ngritura. Sipas saj, dëshmitë e 265 dëshmitarëve, përfshirë edhe zyrtarë të lartë ndërkombëtarë, kanë konfirmuar se ai nuk ka pasur rol komandues apo kontroll efektiv mbi strukturat e UÇK-së dhe nuk ka qenë i përfshirë në ndalime apo veprime të paligjshme. Dhomat e Specializuara kanë publikuar dosjen gjyqësore përfundimtare të mbrojtjes së ish-presidentit Hashim Thaçi, i cili po gjykohej në Hagë bashkë me Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin. Sipas dosjes prej 304-faqesh, mbrojtja ka theksuar se çdo provë e paraqitur përgjatë gjykimit 33-mujorë dëshmon se Thaçi është i pafajshëm dhe se pretendimet e Dick Martyt ishin veçse produkt i një fushate dezinformimi rus. Madje, sipas mbrojtjes, asnjë nga dëshmitarët e prokurorisë nuk ka thënë se Thaçi ishte përgjegjës. “Trupit i janë paraqitur prova nga



265 dëshmitarë. Asnjëri prej tyre nuk ka dëshmuar se ka marrë një urdhër detyrues nga Thaçi dhe se ka vepruar në përputhje me të, apo se është penguar të veprojë ose është ndëshkuar prej tij, apo se e ka konsideruar veten nën kontrollin e tij efektiv. Ekziston një sasi e madhe provash që ngre dyshim të arsyeshëm mbi cilëndo nga këto pretendime. Paqartësia e çështjes së ZPS-së është e qëllimshme. Thaçi nuk mban përgjegjësi si epror dhe as vetë ZPS nuk ka mundur të argumentojë ndryshe, duke dobësuar që në fillim pretendimin e tyre për komandim”, është thënë në

dosjen e dorëzuar nga mbrojtja e Thaçit. Në këtë mënyrë mbrojtja ka përsëritur kërkesën e saj ndaj trupit gjykues sa i përket Hashim Thaçit. “Panelit i kërkohet ta shpallë të pafajshëm Thaçin në të gjitha pikat e aktakuzës dhe ta urdhërojë lirimin e tij të menjëhershëm”, është thënë nga mbrojtja e Thaçit. Sa iu përket dëshmitarëve të mbrojtjes, në dosjen përfundimtare theksohet se Thaçi është shfajësuar edhe në lidhje me të gjitha akuzat e ngritura kundër tij, gjë që është mbështetur edhe nga dëshmitarët ndërkombëtarë.

“Paneli dëgjoi një sërë zyrtarësh të lartë ndërkombëtarë, Komandantin Suprem të Forcave Aleate të NATO-s në Evropë, zëdhënës të Departamentit të Shtetit të ShBA-së, diplomatë të lartë britanikë dhe amerikanë, si dhe zyrtarin e dytë më të lartë të OKB-së në terren. Të gjithë këta kanë bashkëvepruar me Hashim Thaçin dhe kanë pasur qasje në informacionet më të hollësishme diplomatike dhe të inteligjencës në dispozicion. Të gjithë kanë arritur në përfundimin se Thaçi ishte një figurë politike pa ndonjë rol ushtarak brenda UÇK-së, pa komandë dhe kontroll mbi të, dhe pa ndonjë lidhje të njohur me

ndalimet e civilëve, apo aftësi ose detyrim për ta ndaluar dhunën pas luftës”, është thënë në dosjen e dorëzuar nga mbrojtja e Thaçit. Duke marrë parasysh të gjitha dëshmitë dhe dëshmitarët përgjatë këtij procesi të gjatë, mbrojtja thekson se Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk ka paraqitur asnjë provë bindëse se UÇK-ja në përgjithësi dhe Hashim Thaçi në veçanti ka pasur ndonjëherë plan për të fituar apo ushtruar kontroll mbi tërë Kosovën. “Përpjekja e ZPS-së për të rishikuar këtë histori, për ta shndërruar një luftë çlirimtare të mbështetur nga demokracitë kryesore të botës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, nuk mbështetet në fakte. Jeta dhe karriera e Hashim Thaçit i janë kushtuar lirisë dhe pavarësisë së Kosovës”, është thënë në dosjen e dorëzuar nga mbrojtja e Thaçit. Prandaj, përfundimisht sipas mbrojtjes, shpallja e Hashim Thaçit i pafajshëm do të ishte një përfundim i drejtë i këtij aktgjykimi të ndërtuar, sipas tyre, në mungesë të provave. Pas përfundimit të paraqitjes së provave dhe fjalëve përfundimtare nga të gjitha palët, procesi ndaj Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit është tani në fazën e fundit: pritjen e shpalljes së vendimit final të shkallës së parë.

UÇK-ja DHE FILOZOFIA E DINJITETIT

“Lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe e pashmangshme për ta ndalur spastrimin etnik dhe për ta sjellë lirinë” – Bill Clinton



Shkrua: Ethem ÇEKU

Në analizë historike dhe sociopolitike, diskursi negativ dhe përdorimi i epiteteve kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk përbënte një fenomen të rastësishëm, por ishte rezultat i një ndërthurjeje faktorësh strukturorë, ideologjikë dhe psikologjikë që shoqëruan shoqërinë shqiptare në fundin e shekullit XX. Në thelb kjo situatë reflektonte vështirësinë e thellë për të ndërtuar një

koncept të qëndrueshëm dhe të pranueshëm të çlirimit në kushtet e një sistemi të gjatë represiv dhe delegjitimues. Së pari, ndikimi i zgjatur i sistemit jugosllav prodhoi një kulturë politike të mbështetur mbi kontrollin, frikën dhe delegjitimimin sistematik të çdo forme rezistence. Kjo krijoi një klimë të përgjithshme mosbesimi ndaj vetë idesë së çlirimit, duke e bërë artikulumin e një projekti çlirimtar një proces të vështirë dhe të ngarkuar me pengesa psikologjike e ideologjike, të trashëguara ndër breza. Së dyti, propaganda shtetërore serbe, e ndërtuar dhe e orkestruar nga qendrat politike në Beograd, funksionoi si një aparat i sofistikuar diskursiv, i cili e paraqiste UÇK-në si faktor destabilizues dhe

kërcënim për rendin ndërkombëtar. Ky diskurs u përhap jo vetëm në mediat ndërkombëtare, por edhe brenda vetë shoqërisë shqiptare, duke prodhuar një konfuzion të qëllimshëm dhe duke vështirësuar konsolidimin e një vetëdijeje të përbashkët çlirimtare. Së treti, ndarja e brendshme politike dhe strategjike ndër shqiptarë përfaqësonte një dimension tjetër të kësaj krize konceptuale. Në këtë kontekst, lufta e armatosur u perceptua nga disa segmente si rrezik për stabilitetin dhe përkrahjen ndërkombëtare, duke krijuar një tension të brendshëm ndërmjet nevojës për veprim dhe frikës nga pasojat e tij. Së katërti, faktori social dhe ekonomik ndikoi ndjeshëm në këtë proces. Një pjesë e

popullsisë kishte ndërtuar mekanizma mbijetese brenda sistemit ekzistues jugosllav, prandaj çdo ndryshim rrënjësor perceptohej si kërcënim për këtë ekuilibër të brishtë. Kjo gjendje e bënte edhe më të ndërlikuar pranimin e një projekti çlirimtar, i cili kërkonte jo vetëm sakrificë, por edhe një shikim të qartë nga realiteti i imponuar. Së pesti, ky fenomen mund të analizohet në krahasim me modele të tjera evropiane, si ai i Rezistenca Franceze, ku gjatë okupimit nazist një pjesë e shoqërisë mbante qëndrime pasive ose bashkëpunuese, ndërsa rezistenca aktive stigmatizohej dhe delegjitimohej. Vetëm pas çlirimit u arrit një konsensus mbi legjitimitetin e saj historik

dhe politik. Një dinamikë e ngjashme u manifestua edhe në Kosovë, ku koncepti i çlirimit kaloi përmes një procesi të gjatë kundërshtimesh, dyshimesh dhe përplasjesh të brendshme, për t'u konsoliduar përfundimisht pas përfundimit të luftës. Në këtë kuptim, përdorimi i epiteteve kundër UÇK-së duhet interpretuar si reflektim i një tranzicioni të vështirë historik dhe si dëshmi e pengesave të shumta në ndërtimin e një filozofie të përbashkët çlirimtare, e cila kërkonte tejkalimin e frikës, të nënshtrimit dhe të konfuzionit ideologjik. Në përfundim, filozofinë e çlirimit nuk mund ta rrënojë askush dhe aq më pak ata që nuk vijnë nga trangu i lirisë.

ALIBIA E KRIMIT



Shkruan: Hajdin ABAZI

Për shkak të masakrave ndaj civilëve në Kosovë e konkretisht në Reçak (e cila, për fat, pati dëshmitar William Walker) - vendet euroatlantike për ta ndalë një tragjedi si ndaj boshnjakëve ku humbën jetën rreth gjysme milioni civilë, me anë të bombardimeve të NATO-s e ndalën regjimin gjakatar të Millosheviqit. Serbia ishte justifikuar asokohe se forcat serbe kishin luftuar kundër UÇK-së, e jo se kishin bërë masakra ndaj civilëve. 27 vite më pas, në Prishtinë e lirë, publikisht u stis një alibi!

Ekspozita për masakrat në Kosovë në vitet 1998-1999 befas një mëngjes e kishte “pushtuar” kryeqytetin. Ajo ishte derivat i librit të Shkëlzen Gashit. Kjo ishte përpjekja e tij kulmore për ta legjitimuar një shtrembërim të së vërtetës e cila çuditërisht korrespondon me propagandën Millosheviq-Vuçiq! Ndaj ekspozitës e cila duhej t'i jepte jehonë së vërtetës për masakrat serbe në Kosovë e që në fakt e kishte deformuar rëndë pikërisht atë, i pari reagoi Sadik Zeqiri, i mbijetuar i masakrës së Dubravës. Ai nuk mundi të heshte, se heronjtë nuk heshtin kur duhet folur. Për më tepër, ai kapi dhe thelbin strumbullar të shtrembërimit që aspak nuk duket të jetë i rastësishëm. Nuk është thjesht vetëm numri jo i saktë i të masakruarve, sepse, me të drejtë u tha, gabime të tilla mund të ndodhin dhe si shkencëtar e kuptoj këtë.

Porse ekspozita ishte e dizajnuar me të dhëna nga “hulumtimet” e Gashit; dhe gjeneratori është pikërisht ai. Më e rënda është infiltrimi i kuptimeve gjoja të ngjashme, dhe këtu është tërë keqkonceptimi. Kushdo që ka studiuar shkencat politike e di se thelbësore për kuptimin është përdorimi i saktë i koncepteve. Kushdo që synon të shmang të vërtetën, pikërisht aty e bën diversionin kuptimor. Rezultati: një ushtar i UÇK-ës i burgosur bëhet “njeri i armatosur” në burg. Gashi pikërisht këtë kuptim e ka përdredhë. Si rezultat, në disa masakra del se një numër i të vrarëve ishin “njerëz të armatosur”; e kjo u bë absurde kur edhe në burgun e Dubravës paskëshin qenë ushtarët e UÇK-së të burgosur e që ishin “njerëz të armatosur”! Të burgosur të armatosur!!! Një kuptim i këfillë i jep Serbisë

alibi, të thotë, fjala vjen, se forcat serbe duke luftuar kundër “njerëzve të armatosur” padashje kanë vrrarë edhe ndonjë civilë edhe pse këta nuk ishin objektivi kryesor. Tërthorazi, faji i vihet UÇK-së. Ja, lexojeni këtë edhe në librin e Sh. Gashit! Alibi më e madhe nuk ka se si t'i bëhet kryesve të masakrave në Kosovë, e posaçërisht atyre të burgut të Dubravës. Ekspozitën e hoqi kryetari i Prishtinës z.Rama, por ajo nxori në shesh se dëmi ishte edhe më i madh: 500 ekzemplarë të këtij libri janë blerë (15000 euro) nga MPJD dhe janë shpërndarë gjithandej, duke marrë konotacionin e një diversioni diplomatik! Kredibiliteti i pretenduar i Sh. Gashit u diskreditua nga referenca e tij: Natasha Kandiq dhe Fondi për të Drejtën Humanitare. Ia përplasën në fytyrë, ashtu si e meritonte: ushtarët e UÇK të burgosur nuk

ishin të armatosur! Kaq i cekët paskësh qenë Sh. Gashi, sa të mos e kuptojë këtë? Pak duket e besueshme. Ky shtrembërim i së vërtetës buron nga konceptet e tij që janë deri në atë përmasë sa përafrohet me agjendat anti-UÇK. Pasi i dështoi thirrja në referencën, Sh. Gashi iu sul institucioneve se nuk e kane shifrën e saktë të viktimave. Me këtë ai po e bartë shkakun e gabimit të shifrat, kurse defekti real dhe pakrahasimisht më i dëmshëm është te kuptimi që ai e ka përmbysur: “njerëz të armatosur” deri edhe në Burgun e Dubravës! Po të ketë pak dinjitet dhe etikë, ai duhet ta sqarojë publikisht se si i bëri të burgosurit “njerëz të armatosur”, të kërkojë falje, ta tërheq librin e tij dhe t'i kthejë paratë publike që i ka marrë në emër të ndriçimit të së vërtetës për masakrat në Kosovë e që ka përfunduar në alibi të krimeve!

Pezullohen nga puna dy inspektorë dhe zyrtari përgjegjës për punishten në rrugën “Don Shtjefën Kurti”

PRISHTINË, 30 MARS - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka pezulluar nga puna dy inspektorët dhe zyrtarin përgjegjës pas shembjes së dheut në punishten ndërtimore në rrugën “Don Shtjefën Kurti”. Rama ka njoftuar se punishtet ndërtimore do t'i nënshtrohen inspektimit të rreptë. “Janë

pezulluar nga puna dy inspektorët e zonës ku ka ndodhur rasti si dhe zyrtarin përgjegjës për lëndën. Punishtet ndërtimore duhet t'i nënshtrohen inspektimit të rreptë dhe të vazhdueshëm nga Inspektorati Komunal, në mënyrë që të garantohet siguria e punëtorëve, qytetarëve dhe cilësia e

punimeve sipas projektit të pranuar”, ka njoftuar Rama. Ai ka thënë se janë të hapur për bashkëpunim me Prokurorinë Themelore të Prishtinës për hetimet lidhur me këtë rast. Ndërsa Prokuroria Themelore në Prishtinë ka njoftuar se ka iniciuar rast ndaj zyrtarëve përgjegjës të komunës së Prishtinës.



OPOZITA FAJËSON LV-në PËR ÇËSHTJEN E PRESIDENTIT, PARTIA NË PUSHTET SHPRESON NË NJË MARRËVESHJE

Partitë opozitare kanë fajësuar Lëvizjen Vetëvendosje për moszgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës. Përfaqësuesit e këtyre partive kanë thënë se janë kundër imponimit të një emri për president nga partia në pushtet. Ndërsa përfaqësuesit e LV-së në pushtet kanë paralajmëruar takime me opozitën për çështjen e shefit të ri të shtetit. Kryeparlamentarja Albulena Haxhiu ka bërë me dije se sapo të krijohen kushtet do ta ftojë seancën për zgjedhjen e presidentit

PRISHTINË, 30 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka paralajmëruar se do t'i ftojë në takime liderët e partive opozitare, në përpjekje për t'i siguruar votat e nevojshme për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit. Ai ka thënë se deri më tani nuk ka pasur kohë për të zhvilluar konsultime të brendshme lidhur me këto takime për shkak të një vizite në Paris të Francës. Por, ai ka njoftuar se ato do të ndodhin së shpejti. “Do të bëj ftesa për takime për kryetarët e partive opozitare që të shohim se cilat janë rrugët që ta arrijmë numrin prej së paku 80 deputetëve”, ka thënë Kurti. I pyetur se a do të tërhiqen kandidaturat e ministrit të Jashtëm, Glauk Konjufcës dhe deputetes së LV-së, Fatmire Kollçakut, për pozitën e presidentit, Kurti ka thënë se “do të shihet se çka është e mundur ligjërisht”. Sipas tij, për të qenë i sigurt procesi i zgjedhjes së presidentit, nevojitet një mbështetje edhe më e gjerë në Kuvend. “Duhet të jemi rreth 85 të sigurt që ta zgjedhim presidentin aty dhe për këtë do të bëj edhe ftesa dhe do të zhvilloj edhe takime”, ka thënë ai. Kurti nuk ka dhënë hollësi se çfarë ofertash konkrete mund të paraqiten në këto takime, duke shtuar se kjo do të bëhet me dije vetëm pasi të zhvillohen ato. Deklaratat e Kurtit vijnë në një kohë kur procesi për zgjedhjen e presidentit është futur në një afat të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese.

LV-ja shpreson në një marrëveshje për presidentin

Lidhur me çështjen e presidentit, kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, ka thënë se sapo të krijohen kushtet do të vazhdohet seanca për presidentin, e nisur më 5 mars. “Siç u njoftova, kryeministri Kurti sot ka bërë të qartë se do të vazhdojë me ftesat për grupet parlamentare, prandaj uroj që këto diskutime e takime të çojnë deri te një zgjidhje për çështjen e presidentit. Është shumë më e rëndësishme që vendi të mos shkojë në zgjedhje”, ka thënë ajo në një konferencë për medie pas mbledhjes së Kryesisë së



Kuvendit. E pyetur se çfarë ndodh me 30 nënshkrimet për kandidatët për president nëse ndonjëri nga dy kandidatët largohet nga gara, Haxhiu ka thënë se nëse ka vullnet gjendet zgjidhja. “Në raport me situatën aktuale, çfarë është e rëndësishme është vullneti. Rruga për të arritur te zgjidhja sapo të ketë vullnet gjendet. Në këtë drejtim, as Kushtetuta, as ndonjë ligj, as Rregullorja e Kuvendit nuk parasheh situata të ndalimit të tërheqjes ose të kandidatit ose të nënshkrimeve ose çfarë nëse shtohet edhe një. Ju e dini më së shumti katër kandidatë mund të jenë”, ka thënë ajo. Kurse shefja e grupit parlamentar e LV-së, Arbërie Nagavci, ka thënë se shpreson që të arrihet një marrëveshje për zgjidhjen e çështjes së presidentit. “Për çështjen e presidentit Kurti ka bërë të ditur se do t'i vazhdojë diskutimet me krerët e partive opozitare, në këtë rast me të PDK-së dhe LDK-së. Ne presim që të ketë një marrëveshje dhe të arrijmë të zgjedhim presidentin, duke pasur parasysh që janë të panevojshme dhe të padrejta edhe një palë zgjedhje të reja”, ka thënë ajo për mediet. Nagavci ka thënë se beson që shpejt do të organizohen takime për presidentin, por kur është pyetur për çështjen e mundësisë së tërheqjes së nënshkrimeve për dy

kandidatët, ajo ka thënë se janë edhe 44 deputetë që nuk kanë dhënë nënshkrimet. “Nëse nevojitet një rrugë tjetër në raport me një konsensus që mund të arrihet në ndërkohë, është një temë që duhet të shqyrtohet pas propozimeve apo diskutimeve konkrete që mund të kemi në këtë temë”, ka thënë ajo.

Opozita fajëson LV-në për çështjen e presidentit

Partitë opozitare e kanë bërë fajtorë LV-në në pushtet për moszgjedhjen e presidentit. Vlora Çitaku, nënkryetare e Kuvendit nga radhët e PDK-së, u ka thënë gazetarëve se deri më tani nuk kanë pranuar ndonjë ftesë për takim nga Kurti. Ajo nuk ka pranuar të fliste “në mënyrë hipotetike” nëse PDK-ja do të shkojë në takim të Kurtit dhe nëse do të paraqesë ndonjë emër për president. “Ju e dini që Kosova është pa institucione të konsoliduara dhe pa president, jo për shkak të mungesës së ditëve dhe afateve kohore, por për shkak të mungesës së vullnetit politik nga Lëvizja Vetëvendosje. Nuk kemi pranuar asnjë kërkesë. Do ta shohim edhe formën edhe përmbajtjen dhe pastaj do të reagojmë”, ka thënë ajo. Kurse shefja e grupit parlamentar e LDK-së, Jehona Lushaku-Sadriu, ka thënë se partia e saj do të japë

maksimumin që të arrihet një zgjidhje për presidentin. Por, ajo ka thënë se janë kundër që një parti të imponojë një emër nga partia e saj, duke shtuar se kështu do të “kapeshin” të gjitha institucionet kryesore të shtetit. “Është tepër e rëndësishme që në këtë fazë Kosovës t'i jepen institucione funksionale dhe të mos cenohet për asnjë çast funksionaliteti i shtetit. Ne do të japim kontributin tonë për aq sa është përgjegjësia jonë. Por, nuk duhet harruar që përgjegjësinë kryesore e bart partia më e madhe që ka numrin më të madh të deputetëve. Nëse vullneti i saj është të ketë një zgjidhje, do të kemi. Nëse jo, Kosova do të shkojë në zgjedhje”, është shprehur Lushaku-Sadriu. Edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se është përgjegjësi e Kurtit që t'i japë shtetit një president. “Ne mendojmë që është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e kryeministrit Kurti me 66 vota, atëherë edhe tash, t'i japë Kosovës presidentin”, ka thënë ai, duke shtuar se për t'u arritur 80 votat e nevojshme për presidentin duhet një marrëveshje politike. Ai ka shprehur skepticizëm se paralajmërimet e Kurtit për takime për presidentin do të prodhojnë ndonjë rezultat. “Ju e shini vetë, kjo është një metodë pune, një procedurë standarde që ky formacion politik që e udhëheq Kosovën, t'i zvarrisë punët dhe në fund të vijë, të

bëjë një proces kinse po diskutojmë për një president unifikues. Prapë do të ndodhë e njëjta, prapë do të shkojë avazi i njëjtë”, ka thënë Tahiri. Më 25 mars Kushtetuesja ka vendosur se deputetët kanë edhe 34 ditë kohë për ta zgjedhur presidentin e ri, përkatësisht deri më 28 prill. Nëse kjo nuk ndodh, vendi shkon automatikisht në zgjedhje të reja. Takime të tilla mes Kurtit dhe opozitës janë paralajmëruar edhe para seancës së 5 marsit, kur Kuvendi kishte dështuar ta zgjedhë presidentin për shkak të mungesës së kuorumit. Madje kryeministri kishte dërguar ftesa për takim edhe gjatë kohës kur çështja ishte në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, liderët e partive opozitare kishin refuzuar të takoheshin në atë fazë, duke theksuar se pëlqenin ta prisnin vendimin e Kushtetueses përpara se të hynin në bisedime politike. Çështja ka përfunduar në Gjykatën Kushtetuese pasi presidentja Vjosa Osmani kishte dekretuar shpërndarjen e Kuvendit më 6 mars, një ditë pas dështimit të zgjedhjes së presidentit. Gjykata vlerësoi se ky dekret nuk ka prodhuar efekt juridik. Aktualisht Lëvizja Vetëvendosje nuk i ka votat e mjaftueshme për ta zgjedhur e vetme presidentin. Për këtë proces nevojiten të paktën 80 deputetë të pranishëm në sallë dhe dy të tretat e votave në dy raundet e para, ndërsa në raundin e tretë kërkohen 61 vota. Partitë opozitare kanë theksuar se përgjegjësia kryesore për sigurimin e shumicës bie mbi partinë në pushtet, ndërsa kanë kërkuar marrëveshje politike për tejkalimin e situatës. Zgjedhja e presidentit duhet të përfundojë jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të mandatit të presidentes aktuale, Vjosa Osmani, e cila përmbyll mandatin e saj më 5 prill. Vetë Osmani e synonte edhe një mandat të dytë, mirëpo ajo nuk ka gëzuar mbështetjen e partive. Për partinë në pushtet, ajo nuk i kishte votat e nevojshme, ndërsa për partitë e tjera ajo nuk e ka personifikuar unitetin e nevojshëm që i duhet figurës së presidentit. Nëse palët nuk arrijnë marrëveshje brenda afatit të caktuar, Kosova rrezikon të hyjë në një cikël të ri zgjedhjesh, vetëm pak kohë pas përfundimit të atyre të fundit.

ZRrE-ja: Tarifat e energjisë mbeten të pandryshuara deri në vendimin përfundimtar

PRISHTINË, 30 MARS - Janë bërë dy muaj që kur tre operatorët kryesorë të sektorit energjetik në vend, KEDS, KESCO dhe KOSTT, kanë dorëzuar kërkesat për rritjen e tarifave të energjisë elektrike në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRrE). Këto kompani kanë kërkuar një rritje prej mbi 20-përqindësh. Por ani pse jemi vetëm edhe dy ditë nga data një prill kur ZRrE-ja shqyrton dhe cakton tarifat e energjisë elektrike pikërisht me këtë datë, kryetari i Bordit të ZRrE-

së, Ymer Fejzullahu, ka bërë me dije për “Ekonomia Online” se tarifatat aktuale do të mbeten në fuqi deri në publikimin e raportit përfundimtar dhe përmbylljen e procesit të konsultimit publik. Ai ka thënë se ende nuk ka asnjë vendim derisa të publikohet raporti përfundimtar. “Jo, s’ka ende. Po presim gjatë javës t’i publikojmë raportet. Tani janë nja dy javë ditë diskutim publik e atëherë mundemi me pa qysh me e nxjerrë qëndrimin apo diçka”, ka thënë ai.

Fejzullahu ka thënë se pas publikimit të raportit do të jenë shtesë edhe 14 ditë dhe pas ankesave ose komenteve do të ketë një vendim. “Jo, jo, jo. Njëherë duhet me dalë raportit. Tani është me dalë raportit në konsultim publik, dy javë ditë është obligim me ligj. Edhe tani pas nja dy jave, nëse ka komente të palëve, tani merret vendimi”, ka thënë ai. Fejzullahu ka theksuar se tarifatat do të mbesin të njëjta edhe pas një prillit pasi që, sipas tij, “për këtë edhe raporti i stafit del

tash dhe e vlerësojnë ata. Pas këtij raportit tani duhet edhe komentet e palëve, tek është vendimi ma vonë. Në këtë fazë ende është në shqyrtim të departamentet. Ne nuk e kemi, qysh me thënë, as qasje në këtë fazë. Po, domethënë më 1 prill, deri atëherë mbesin tarifatat që janë ekzistuese”, ka thënë Fejzullahu. Ndërkohë KESCO ka propozuar një rritje mbi 20 përqind për vitin 2026, duke e arsyetuar këtë me rritjen e kostove operative dhe nevojën



për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike.

MIRATOHET VENDIMI PËR PAGËN E 13 PËR PUNONJËSIT QË PAGUHEN NGA BUXHETI I SHTETIT

PRISHTINË, 30 MARS - Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për pagën e 13 për punonjësit që paguhet nga buxheti i shtetit. Paga e 13 pritet të ekzekutohet sot (e martë) së bashku me pagën e muajit mars. Miratimi i këtij vendimi është bërë të hënën në mbledhjen e kabinetit qeveritar, ku të gjithë ministrat ishin për. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë e paga e 13 mbështet mirëqenien e familjeve të punëtorëve si dhe lehtëson barrën financiare. “Siç kemi premtuar, po e realizojmë këtë zotim duke dëshmuar se përgjegjësia ndaj punëtorëve përkethehet në veprime konkrete. Paga e 13 synon ta mbështet mirëqenien e familjeve të tyre dhe ta lehtësojë barrën financiare”, ka thënë Kurti.



Ndërsa ministri i Financave, Hekruan Murati, ka bërë me dije se paga e 13 u takon të gjithë punëtorëve publikë që kanë punuar 12 muaj të plotë. “Kanë

qenë disa raste, kur është shikuar se si të zbatohet në mënyrën më të mirë të mundshme. Është rasti i të gjithë atyre personave që tashmë kanë 12 muaj të plotë në

sektorin publik dhe e marrin pagën e 13, e cila kur të llogaritet është e barabartë me vlerën e koeficientit shumëzuar me njësinë e koeficienteve që ka pozita përkatëse për personin, i cili është në listën e pagave në muajin mars”, ka thënë Murati. Ai ka treguar se edhe personave që nuk kanë punuar plotësisht 12 muaj do t’u paguhet paga e 13 në mënyrë të pjesshme. “Kemi hasur edhe në rastet kur ka situata që nuk i kanë përmbushur të gjithë 12 muajt. Për me qenë sa më korrektë, jemi dakorduar me Thesarin e Shtetit dhe kemi siguruar fonde të mjaftueshme që për këta persona që s’i kanë të përmbushur 12 muaj, të jepet pjesa e pjesshme. Pra, për aq muaj sa kanë qenë të angazhuar për 12 muaj e fundit, proporcionalisht u takon edhe

një pjesë e pagës së 13”, ka treguar Murati, duke thënë se ngjashëm veprohet edhe me ata që punojnë me orar të shkurtuar. Ai ka thënë se paga e 13 u takon edhe grave lehona që janë apo gjatë 12 muajve kanë qenë në pushim të lehonisë. “Njëkohësisht jemi përkujdesur edhe për gratë lehona të cilat janë në pushim të lehonisë apo kanë qenë në pushim të lehonisë përgjatë këtyre 12 muajve. Muajt e kaluar në pushimin e lehonisë të njihen sikurse muajt që të kenë punuar me orar të plotë, kjo në mënyrë që të mos kalojnë te paga e pjesshme, por ta marrin pagën e 13 të plotë”, ka thënë ministri Murati. Kjo pagesë është paraparë në buxhetin e miratuar më 20 shkurt dhe të dekretuar nga presidentja Vjosa Osmani.

KURTI PARALAJMËRON LIGJ PËR ÇMIMET TAVAN, KUNDËRSHTON PROPOZIMIN PËR HEQJEN E TVSH-së DHE AKCIZËS PËR KARBURANTET

PRISHTINË, 30 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka kundërshtuar propozimet për heqjen e TVSh-së dhe akcizës për karburantet, duke i cilësuar ato të pamenduara mirë dhe të pabazuara në praktika të suksesshme ekonomike. Sipas tij, masa të tilla mund të përfundojnë duke favorizuar përfitimet e kompanive, në vend se ta lehtësojnë barrën e qytetarëve. Ai ka thënë se edhe vende të fuqishme si Shtetet e Bashkuara të Amerikës po përballen me rritjen e kostove si

pasojë e zhvillimeve ndërkombëtare, duke përmendur ndikimin e konfliktit në ngushticën e Hormuzit në tregjet globale të energjisë. “Bindja ime e fuqishme është që këto propozime për heqje të TVSh-së e të akcizës nuk janë mirë të menduara dhe nuk bazohen në përvoja të suksesshme apo në dije ekonomike. Është e rëndësishme të kemi kujdes, të mos i shërbejmë super profitit të ndokujt në vend se t’ua zbusim barrën qytetarëve. Edhe vetë



shteti më i fuqishëm i ShBA-së është duke e vuajtur koston e luftës që po zhvillohet në

ngushticën e Hormuzit”, ka thënë Kurti në një konferencë për medie pas mbledhjes së qeverisë. Në këtë drejtim, Kurti ka thënë se qeveria është duke përgatitur një ligj për vendosjen e tavanit të çmimeve për produktet bazë. Ai ka thënë se një nismë e tillë është vonuar në të kaluarën për shkak të sfidave ligjore dhe ankesave në Gjykata Kushtetuese e Kosovës, por ka shprehur bindjen se ligji do të miratohet së shpejti. Kurti ka deklaruar se Kosova mbetet

plotësisht e varur nga importi i naftës, duke theksuar se mungesa e burimeve vendore dhe e rafinerive e bën vendin të ekspozuar drejtpërdrejt ndaj luhatjeve të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Sipas tij, kjo situatë ndikon që kostot e rritura jashtë vendit të reflektohen edhe më fort në tregun e brendshëm, duke rënduar mbi qytetarët. Ai ka thënë se Kosova jo vetëm që nuk prodhon naftë, por as nuk ka kapacitete për përpunimin e saj, çfarë e shton ndikimin e inflacionit të importuar.

Qeveria miraton Projektligjin për Banimin Social dhe të Përballueshëm

PRISHTINË, 30 MARS - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së hënës ka miratuar Projektligjin për Banimin Social dhe të Përballueshëm. Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit

Hapësinor, Fitore Pacolli, tha se ky është një nga zotimet kryesore të qeverisë për të garantuar banim të dinjitetshëm për qytetarët. “Projektligji parasheh krijimin e programeve të banimit, përmes

përcaktimit të rregullave dhe procedurave për zbatimin dhe shpërndarjen e banesave, si dhe përcaktimin e kriterëve të përfitimit për familjet dhe individët në nevojë. Me realizimin

e këtij projekti po e përmbushim edhe një zotim tonin në mbështetje për çiftet e reja dhe familjet në nevojë në vendin tonë”, ka shkruar Pacolli në “Facebook” pas mbledhjes së qeverisë.



MEHMET SHEHU, VDEKJA MISTERIOZE E NJË KRYEMINISTRI SIPAS ARKIVAVE BRITANIKE



Jon HALLIDAY

Më 18 dhjetor 1981, Radio Tirana njoftoi se kryeministri i Shqipërisë prej shumë vitesh, Mehmet Shehu, kishte kryer vetëvrasje një natë më parë, “në një moment krize nervore”. Edhe pse vetëvrasja zakonisht shihej si diçka e papranueshme në vendet komuniste ku, në teori, askush nuk kishte arsye të dëshironte të largohej nga “parajsa”, radioja e përmendi Shehun si “shok” dhe i dha të gjitha titujt e tij zyrtarë. Por pothuajse një vit më vonë, udhëheqësi i Shqipërisë, Enver Hoxha, deklaroi se Shehu kishte qenë një agent i shumëfishtë: i Gestapos, i SIM-it italian, i Jugosllavisë, i KGB-së, i SHBA-ve dhe i Britanisë. Këto akuza u pritën me mosbesim dhe ironi, duke u parë si një produkt i paranojës së Hoxhës. Aq më tepër që ai pretendoi se Shehu ishte vetëvrarë pasi ishte kritikuar për fejesën e djalit të tij me një vajzë nga një familje që përmbante “6-7 kriminelë lufte”. Madje, pak javë para se vetë Hoxha të vdiste në prill 1985, gazeta zyrtare e Partisë tha se

Shehu ishte “likuiduar”, edhe pse më pas një zëdhënës e mohoi që kjo të nënkuptonte ekzekutim. Në një regjim ku gjuha shpesh ishte e mbushur me hiperbola, këto shprehje janë të vështira për t’u interpretuar.

Deklaratat e çuditshme të një spiuni britanik

Ashtu si shumica e vëzhguesve të tjerë, fillimisht i hodha poshtë akuzat e Enver Hoxhës si fantazi dhe pa interes. Derisa u befasova nga toni i butë i një ish-agenti shumë konservator të “Special Operations Executive” në Shqipëri. Krejt papritur, i kisha kërkuar mendimin për Hoxhën, ai më tha: “Çuditërisht, ai kurrë nuk më ka impresionuar aq sa Mehmet Shehu.” Vlerësime të tjera erdhën nga njerëz të tjerë të SOE-së: “në të njëjtën gjatësi vale me ne”; “pa diskutim më i miri nga ai grup maskarenjsh” (edhe pse ky agent vuri në dukje se “Mehmeti i vjetër e humbi lojën”); dhe mbi të gjitha: “i vetmi udhëheqës që mund të ishte kthyer nga ana jonë ose të ishte tërhequr nga Perëndimi”. Dyshimet e mia u përforcuan kur

një ish-anëtar shumë i zgjuar (dhe shumë i djathtë) i SOE-së pohoi me bindje se, pavarësisht prirjes së Hoxhës për të eliminuar bashkëpunëtorët e tij, pas spastrimeve të njëpasnjëshme kishte gjithmonë një arsye të fortë.

Arsyet e mundshme të eliminimit

Cilat ishin arsyet e mundshme “të mira”? Në kohën e vdekjes së Mehmet Shehu, spekulimet përqendroheshin në tre çështje:

1. mosmarrëveshje mbi një hapje të mundshme drejt Perëndimit pas prishjes së Shqipërisë me Kinën në vitet 1977–78;
2. një përplasje politike mbi Kosovën, rajonin e Jugosllavisë me shumicë shqiptare, ku kishin shpërthyer trazira të rënda në pranverën e vitit 1981;
3. çështja e pasardhësit të Enver Hoxhës (73 vjeç në dhjetor 1981). Asnjëra prej këtyre nuk dukej e mjaftueshme për të shpjeguar përçarjen mes Hoxhës dhe Shehut: në fund të fundit, ata kishin përballuar së bashku shumë stuhi. Pse ishte çarë

aleanca e tyre pikërisht tani, pas gati katër dekadash bashkëpunimi? Dhe gjithsesi, cili do të kishte qenë thelbi i mosmarrëveshjes? Lavdërimi për “Mehmetin e vjetër” nga agjentët e Special Operations Executive sugjeronte se një shqyrtim i dosjeve (të pastruara) në Arkivin Publik mund të ishte i dobishëm. Çfarë kishte thënë SOE për Shehun gjatë luftës, kur agjentët e saj ishin të përfshirë ngushtë me të, ashtu siç kishin qenë edhe me Hoxhën?

Nga Lufta e Spanjës, në Luftën Çlirimtare

Kush ishte Mehmet Shehu? I lindur në vitin 1913, djali i një shehu mysliman të devotshëm, ai paraqitej pothuajse njëzëri në burimet e botuara si krahun më i ashpër brenda një regjimi shumë të ashpër. Ai kishte luftuar në Spanjë, ku komandoi Batalionin e Katërt të Brigadës Ndërkombëtare “Garibaldi” në fazat e fundit të Luftës Civile Spanjolle. Vitet 1939–42 i kaloi në një kamp internimi në Francë, ku iu bashkua Partisë Komuniste

Italiane. Pas kthimit në Shqipëri, ai u bë me shpejtësi komandanti kryesor ushtarak i partizanëve. Ai njihej njëzëri, si nga miqtë ashtu edhe nga armiqtë, si lideri ushtarak partizan më i aftë. Shehu udhëhoqi forcat që çliruan kryeqytetin, Tiranën, nga gjermanët në nëntor 1944. Shqipëria ishte i vetmi vend në Evropë, madje i vetmi vend në botë i pushtuar nga ndonjë prej fuqive të Boshtit, që u çlirua pa zbarkimin në shkallë të gjerë të një ushtrie të huaj në territorin e saj.

Pas luftës, njeriu i dytë më i pushtetshëm

Pas luftës, Mehmet Shehu u bë Ministër i Brendshëm, Ministër i Mbrojtjes dhe Kryeministër (1954–1981). Për më shumë se tre dekada, ai ishte njeriu i dytë më i pushtetshëm në vend. Vlerësimet për të prirën të jenë të ashpra. Një agent britanik, David Smiley, shkroi se Shehu “mburrej” se u kishte prerë vetë fytyrën e 70 robërve italianë gjatë luftës. Nikita Hrushovi shkroi në kujtimet e tij se Josip Broz Tito i kishte thënë që Shehu kishte mbytur paraardhësin e tij si

Ministër i Brendshëm, Koci Xoxe. Hrushovi e quajti Shehun dhe Enver Hoxhe4n “më keq se kafshë, janë monstra”. Një artikull në revistën amerikane Collier’s, në kulmin e Luftës së Ftohtë në vitin 1951, pretendonte se Shehu njihej në Tiranë si “Kasapi” dhe se i pëlqente të endej rrugëve të kryeqytetit i maskuar. Artikulli e përshkruante si “një version i gjatë dhe i dobët, tip Hollywood-i, i një vrasësi ballkanik”. Vetë Shehu bëri pak për ta zbehur këtë imazh. Në vitin 1961, në kulmin e përplasjes së Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, ai raportohet t’i ketë thënë Kongresit të Katërt të Partisë: “Për ata që i dalin përpara unitetit të partisë: një pështymë në fytyrë, një goditje në nofull dhe, nëse është e nevojshme, një plumb në kokë.” Vështirë se mund të konsiderohej një kandidat ideal për të qenë “njeriu i Britanisë” në Tiranë.

Mehmet Shehu sipas dosjeve

Gjëja e parë që doli nga dosjet që pashë ishte një mungesë: nuk kishte asnjë referencë për ndonjë akt mizorie nga ana e Mehmet Shehut. Por kjo mund të shpjegohej lehtësisht me faktin se vrasja e robërve ishte një praktikë e përhapur në të dyja anët gjatë luftës në Shqipëri. Së dyti, dhe më e rëndësishmja, oficerët britanikë më pranë Shehut parashikonin në atë kohë (mesi i vitit 1944) një përballje të mundshme në të ardhmen, mes tij dhe Enver Hoxhës. Duke diskutuar mundësinë e një përçarjeje në lëvizjen komuniste, ata shkruanin: “Personaliteti kryesor i përfshirë është Mehmet Shehu... Është e vështirë të thuhet nëse do të ketë ndonjëherë një përballje [me Hoxhën] apo jo. Ai është një njeri krenar dhe i fuqishëm, por edhe me ideale...” Dallimet në atë kohë preknin çështje themelore. Në kulmin e luftës civile, në korrik 1944, kur Hoxha po përpiquej me çdo kusht të shtypte kundërshtarët e djathtë (Ballin Kombëtar dhe ndjekësit e mbretit në mërgim, Zogu I), oficeri i mirëinformuar britanik, W. V. G. Smith, i cili e njihte mirë Shehun, raportonte se: “Shehu beson se ekziston mundësia e një kompromisi.” Një qëndrim i tillë ishte krejtësisht i papranueshëm për Hoxhën.

Tre dekada, njeriu i dytë pas Enver Hoxhës

Pas luftës, Shehu u bë Ministër i Brendshëm, Ministër i Mbrojtjes dhe më pas kryeministër (1954–1981). Për më shumë se tre dekada, ai ishte njeriu i dytë më i fuqishëm në vend.

Megjithatë, reputacioni i tij ishte ai i një personazhi të ashpër. Një agent britanik shkroi se Shehu mburrej se ua kishte prerë vetë fytin e 70 robërve italianë. Hrushovi e përshkroi atë dhe Hoxhën si “më keq se kafshë”. Në SHBA, ai u quajt “Kasapi”. Vetë Shehu nuk e zbuti këtë imazh. Në vitin 1961, ai deklaroi: “Për ata që i dalin përpara unitetit të partisë: një pështymë në fytyrë, një goditje në nofull dhe, nëse duhet, një plumb në kokë.”

E vërteta sipas dokumentave britanike

Por dokumentet britanike tregojnë diçka interesante: nuk kishte prova të drejtpërdrejta për mizori të jashtëzakonshme nga ana e tij. Më e rëndësishmja, disa oficerë britanikë parashikonin një përplasje të ardhshme mes Shehut dhe Hoxhës. Në mes të luftës, në vitin 1944, ndërsa Hoxha kërkonte eliminimin e kundërshtarëve të tij, Shehu besoej se ishte më i hapur për kompromis. Kjo ishte një pikë thelbësore dallimi mes tyre. Një raport i SOE-së në nëntor 1944 e përmend Shehun si një figurë të rëndësishme për një opozitë të mundshme ndaj Hoxhës. Ai përshkruhej si ambicioz dhe shumë i respektuar, por jo plotësisht besnik ndaj partisë. Madje sugjerohej që Britania duhej të mbështeste elementët e tillë. Por dokumentet britanike shkojnë shumë më tej sesa thjesht parashikimi i një përçarjeje mes Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut (gjë që, deri diku, mund të konsiderohet si një tipar i zakonshëm i raporteve mbi lëvizjet komuniste nga agjentë kryesisht të djathtë).

Shpresat e britanikëve tek Mehmet Shehu

Një raport nga Special Operations Executive në nëntor 1944, pikërisht në momentin kur partizanët po përgatiteshin për ofensivën përfundimtare për të dëbuar gjermanët dhe për të marrë Tiranën, përmbledh atë që (pretendohej se ishte) konsensusi pas marrjes në pyetje të 12 agjentëve britanikë të sapodalë nga Shqipëria, dhe e identifikon Shehun si mbajtësin e shpresave britanike për rrëzimin e Hoxhës. Në një seksion të titulluar “Ndikimi britanik”, dokumenti pretendon (shumë pak bindshëm) se “shumica e vendit ka një prirje të fshehtë pro-britanike dhe do të mirëpriste një pushtim britanik.” Më tej vijon: “është e qartë se ka disa që e vlerësojnë atë që ka bërë Britania dhe që janë thelbësisht kundër politikës aktuale të Partisë, por nuk janë në gjendje t’i shprehin hapur pikëpamjet e

tyre...” Është “e rëndësishme të merret në konsideratë opozita e mundshme brenda Lëvizjes dhe drejtuesit e saj të mundshëm”. Emri i dytë (nga pesë) që përmenden është ai i Shehut, i përshkruar si “një njeri personalisht ambicioz dhe mendjemadh, i cili prej kohësh është mbajtur nën kontroll nga Partia. Ai është pa dyshim figura ushtarake më e respektuar dhe më e rëndësishme brenda Lëvizjes... Ai është komunist, por ambicia e tij personale tejkalon besnikërinë ndaj Partisë.” Dokumenti përfundon me këto fjalë: “duhet bërë çdo përpjekje për të parandaluar eliminimin e atyre elementëve pro-britanikë që tashmë i njohim dhe të përpiqemi t’i forcojmë këta në mënyrë të padukshme.”

Thjesht dëshira

Në vetvete, kjo nuk provon asgjë tjetër veçse dëshirë të kotë, një dëshirë e rrëzuar nga një raport i detajuar disa javë më vonë nga një prej agjentëve më të aftë të Special Operations Executive në Shqipëri, Alan Hare (më vonë kryetar i Pearson). Në një pjesë ku diskutohej mundësia e mbështetjes britanike për një revoltë kundër Enver Hoxhës, Hare shkruante: “Ne tani, për mirë apo për keq, jemi identifikuar me zogistët”, mbështetësit e Zogut I “në Shqipëri, dhe urrehemi e nuk besohemi nga pjesa më e madhe e popullsisë për këtë arsye ...” Kjo pjesë ndodhet në një seksion që trajtonte FNÇ-në – partizanët – dhe titullohej “Krahu i djathtë i FNÇ-së dhe rëndësia e tij”. Aty diskutohen tre grupe që mund të ngriheshin kundër regjimit të Hoxhës. Kandidati kryesor në grupin e tretë është Mehmet Shehu, për të cilin Hare mendonte se ndoshta do të kërkonte mbështetje nga e majta, por mund të përpiquej edhe nga e djathta me ushtrinë, që do të ishte shansi i tij më i mirë. Një lëvizje e tillë do të kërkonte mbështetje nga një fuqi e madhe e jashtme, dhe e vetmja do të ishte Britania e Madhe. Megjithatë, Hare vazhdon duke thënë se një mbështetje e tillë është shumë pak e mundshme, dhe gjithsesi, çdo udhëheqës që do të mbështetej nga britanikët do të ishte i destinuar të dështonte. Sjellja e Britanisë, shkruan ai, “po e bën të papëlqyer sigurimin e mbështetjes së Aleatëve tek populli dhe konsiderohet e pasigurt nga drejtuesit”. Hare, që mbi të gjitha është realist, e përmbledh kështu: “është e qartë se, në situatën aktuale politike në Ballkan, shanset për të ushtruar ndikim politik mbi Shqipërinë me mjete paqësore, në njëzet vitet e ardhshme, janë të pakta.”



Hapja e arkivave britanike dhe qeveria shqiptare

Kur arkivat britanike të kohës së luftës u hapën (pjesërisht) në vitet 1970 (30 vjet pas ngjarjeve), qeveria shqiptare dërgoi një nga historianët e saj më të rëndësishëm në Londër për të shqyrtuar dosjet. Rezultati i këtij studimi u botua në Tiranë, në anglisht, në vitin 1981: From the Annals of British Diplomacy: The Anti-Albanian Plans of Great Britain during the Second World War according to Foreign Office Documents of 1939–1944, nga Arben Puto. Ky është një vëllim i studiuar mirë. Shënimet tregojnë se Puto arriti deri te dosja që përmbante provat më komprometuese lidhur me shpresat e Britanisë për Mehmet Shehun. Por Puto nuk citon informacionin për Shehun, as ndonjë gjë tjetër nga ajo dosje, e cila përmban edhe shumë materiale të tjera interesante. Këtu koha është thelbësore. Libri i Putos u botua në vitin 1981. Shehu vdiq në dhjetor 1981. Në janar 1982, Enver Hoxha publikoi denoncimin e tij të parë ndaj Shehut, duke cituar disa dokumente zyrtare britanike, me të tjera që do të pasonin më vonë gjatë atij viti.

Zbulimet e arkivave britanike në duart e Enver Hoxhës

Ajo që duket se ka ndodhur është se Arben Puto gjeti dosjet në të cilat Mehmet Shehu paraqitej si një “element pro-britanik”. Këto ishin eksplozive. Ai duhej t’ia tregonte ato Enver Hoxhës. Nuk mund të ketë qenë lajm për Hoxhën që gjatë luftës kishte pasur mosmarrëveshje serioze politike mes tij dhe Shehut. Por të shihje dokumente të hartuara nga agjentë të inteligjencës britanike, disa prej të cilëve kishin qenë aktivë në përpjekjen për pushtimin e Shqipërisë në vitin 1949, ku kryeministri yt renditej i dyti në një listë “elementësh pro-

britanikë” që duhej të mbroheshin dhe “të forcoheshin në mënyrë të padukshme”, do të mjaftonte për të ndezur një dyshim vdekjeprurës, në një mendje kronikisht dyshuese. Dokumentet britanike, padyshim, nuk mund të shfaqeshin për herë të parë në librin e Putos ndërsa Shehu ishte ende kryeministër. Hoxha, me sa duket, i mbajti dokumentet derisa shpërtheu një përplasje e madhe politike në fund të vitit 1981, dhe më pas i përdori ato si goditjen përfundimtare në përballjen me Shehun. Pastaj, si udhëheqësi largpamës, gjithmonë vigilent dhe “zbuluesi” kryesor, vetë Hoxha publikoi zbulimet nga arkivat. Në politikën shqiptare të pasluftës, çdo konflikti, qoftë për politikën e brendshme apo të jashtme, i është dhënë gjithmonë një dimension i huaj (duke reflektuar si ksenofobinë tradicionale shqiptare, ashtu edhe praktikën staliniste). Të gjithë bashkëpunëtorët e eliminuar nga Hoxha, dhe janë të shumtë, u denoncuan si agjentë të ndonjë fuqie të huaj. E kaluara shumëgjuhëshe dhe internacionaliste e Shehut e bënte atë të përshtatshëm për një zinxhir të gjatë “padronësh” të pretenduar të huaj. Hoxha tallte raportimet perëndimore dhe jugosllave se kishte pasur një shkëmbim zjarri, duke e quajtur “një skenar të modeluar sipas filmave western, me përleshje me armë që ndodhnin në sallonet e asaj kohe!” por, sigurisht, kjo ishte edhe mënyra shqiptare e të bërit të gjërave. “Mehmeti i vjetër” e humbi lojën dhe mori një plumb. Jo sepse ishte vërtet një agent britanik, por sepse britanikët e kishin përmendur si një njeri të përshtatshëm për të udhëhequr një lëvizje që do të rrëzonte Hoxhën, dhe kjo ishte më se e mjaftueshme që Hoxha të vendoste ta eliminonte. / London Review of Books (Vol. 8 No. 17 · 9 Tetor 1986) – *Bota.al*



KOSOVA LUAN SONTE KUNDËR TURQISË PËR LAVDI DHE HISTORI

Kombëtarja e Kosovës do ta luajë sonte finalen e “play-off”-it për Kupën e Botës 2026 kundër Turqisë. Kjo ndeshje ka rëndësi historike për Kosovën pasi ka mundësinë që për herë të parë të luajë në Kupën e Botës. Përzgjedhësi i Kosovës, Franco Foda, ka deklaruar se shanset për ta fituar këtë ndeshje janë 50-50. Ndërsa kapiteni i Kosovës, Vedat Muriqi, ka shprehur optimizëm se Kosova do të triumfojë në përballjen ndaj Turqisë

PRISHTINË, 30 MARS - Kombëtarja e Kosovës në futboll sonte (e martë) në stadiumin “Fadil Vokrri” do ta zhvillojë ndeshjen më të rëndësishme në historinë e saj. Në orën 20:45 Kosova do ta luajë finalen e “play-off”-it për Kupën e Botës 2026 kundër Turqisë. Në rast fitoreje, Kosova do të luajë për herë të parë në historinë e saj në Kupën e Botës, e cila mbahet sivjet në ShBA, Kanada dhe Meksikë. Djelmohat dardanë i kanë bërë të gjitha përgatitjet për ndeshjen me Turqinë. Një ditë para ndeshjes përzgjedhësi i Kosovës, Franco Foda, ka lavdëruar Kombëtaren e Turqisë, por ka thënë se “Dardanët” do të bëjnë çmos për të shkuar në Kupën e Botës. Ai në një konferencë për medie ka deklaruar se shanset janë 50-50, meqenëse Kosova me plot meritë ka arritur në finale. “Ekipi i Turqisë është shumë i fortë edhe në aspektin e lojtarëve individualë si Yildiz, Guler e

Calhanoglu. Janë kualitativë. Por edhe ne jemi të mirë. Jemi në finale me plot meritë. Gjasat janë 50-50. Ne do të japim gjithçka për të fituar. Padyshim që vërehet se është ngjarje shumë e rëndësishme. Kurrë s’ka pasur kaq shumë gazetarë. Po luajmë për kualifikimin në Kampionatin Botëror. Është mirë që jemi të motivuar, por ta mbajmë ‘kokën në vend’”, ka thënë Foda. Ndërsa kapiteni i Kosovës, Vedat Muriqi, ka shprehur optimizëm se Kosova do të triumfojë në përballjen ndaj Turqisë. I pyetur se nëse ka ardhur koha të shënojë në ndeshjen vendimtare pasi “nuk e ka gjetur golin që disa ndeshje”, Muriqi ka nënvizuar se suksesi i ekipit është prioritet. “Gjithmonë kam thënë se nuk më intereson të shënoj gola, përderisa fiton ekipi. Jemi t’u fol për shtetin, jemi në finale kështu që s’më intereson aspak kush shënon gola. Pas pavarësisë mund të jetë lumturia më e mirë e shtetit tonë. Nuk dua t’u bëj



presion bashkëlojtarëve apo vetes, por besoj në fitore e pastaj të festojmë në shesh”, ka thënë Muriqi.

Kurti viziton Kombëtaren para finales me Turqinë:
Përmes jush kemi mundësinë ta vendosim Kosovën në sytë e mbarë njerëzimit

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar kampin e Kombëtares së Kosovës për ta përgëzuar ekipin për arritjen në finalen e “play-off”-it për Kupën e Botës 2026 dhe për t’i ofruar mbështetje para kësaj sfide historike përballë Turqisë. Fillimisht, presidenti i FFK-së, Agim Ademi, e ka falënderuar kryeministrin Kurti, ministrin e Sportit, Blerim Gashiani dhe zëvendësministren Daulina Osmani, për përkrahjen e vazhdueshme ndaj ekipit kombëtar. Në fjalën e tij para futbollistëve dhe stafit, kryeministri Kurti ka uruar “Dardanët” për fitoren historike në Bratisllavë, duke theksuar se rrugëtimi deri në finale është plotësisht i merituar. Ai ka vënë në pah statistikën dhe paraqitjet e ekipit gjatë këtij cikli, duke

nënvizuar se “10 gola të shënuar në 7 ndeshje gjatë këtij rrugëtimi janë dëshmia më e mirë se kjo finale është më shumë se e merituar”. Kurti ka theksuar punën e madhe, përkushtimin dhe unitetin e skuadrës, duke kujtuar se Kombëtarja ka zhvilluar një seri mbresëlënëse rezultatesh, përfshirë fitore ndaj Suedisë, Sllovenisë, Islandës dhe Sllovakisë gjatë vitit të fundit. Duke folur për kundërshtarin, ai ka thënë se Turqia është një ekip cilësor, njëkohësisht u kërkoi futbollistëve të kenë besim në vetvete. “Mos e shikoni

kundërshtarin më shumë sesa veten. Ju e keni kundërshtarin e fortë të martën mbrëma, por ata e kanë kundërshtarin më të fortë se ju, e ai jeni pikërisht ju djemtë e Kosovës”, ka thënë Kurti. Ai ka thënë se kualifikimi në Kupën e Botës përbën një hap të jashtëzakonshëm për vendin, duke e vendosur Kosovën në qendër të vëmendjes globale. Sipas tij, miliona shikues në mbarë botën ndjekin këtë ngjarje dhe përmes Kombëtares ekziston mundësia që historia dhe talenti i Kosovës të paraqiten në arenën më të madhe.

Qeveria ndan 500 mijë euro për Kombëtaren, premtion edhe një milion të tjera nëse mposht Turqinë

Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për ndarjen e 500 mijë eurove për Kombëtaren e Kosovës në futboll pas fitores së shënuar të enjten 4:3 në udhëtim ndaj Sllovakisë në gjysmëfinale të “play-off”-it për Kupën e Botës. Me këtë rast, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka premtuar një milion euro të tjera nëse djemtë e Kosovës fitojnë kundër Turqisë sonte (e

martë). Gjatë fjalës së tij në mbledhjen e qeverisë, pos kësaj shume, ai ka thënë se nëse Kosova shkon tutje, do të ketë edhe shpërblime të tjera. “Po zotohemi sot se nëse shkojmë tutje dhe kualifikohemi, do të ketë shpërblime që nuk ua merr mendja për sukseset që do të pasojmë në Kampionatin Botëror i cili do të mbahet në ShBA”, ka thënë Kurti.


Arbër Hoxha në kampionatin polak?

Varshavë, 30 mars - Klubi polak Widzew Lodz është në negociatë të avancuara për të sjellë sulmuesin e Dinamos, Arbër Hoxha, i cili mund të jetë një nga transferimet më të profilit të lartë në Ekstraklasa,

shkruan gazetari Tomasz Wlodarczyk, i cili ndiqet nga pothuajse 200 mijë njerëz në platformën “X”. Lojtari i Kombëtares shqiptare, i cili ka shënuar një gol kundër Polonisë në gjysmëfinalen e

play-off të Kupës së Botës të enjten, është një objektivi për klubin e Lodzit. Sipas Wlodarczyk, Widzew tashmë ka zhvilluar bisedime dhe thuhet se është arritur një marrëveshje paraprake me Dinamon dhe

vetë lojtarin për një transferim veror. Vlera e punës vlerësohet në rreth 5 milionë euro. Megjithatë, i gjithë transferimi është i kushtëzuar nga mbijetesa e klubit nga Lodz në Ekstraklasa.





SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita:	Analist/e i Ri/e i Sigurisë Kibernetike
Grada:	P07
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë
Divizioni:	Sigurisë Kibernetike dhe Vazhdimësisë
Raporton tek:	Udhëheqësit të Divizionit të Sigurisë Kibernetike dhe Vazhdimësisë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon në konfigurimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe veglave bazë të sigurisë së informacionit nën mbikëqyrje.
- Monitoron rrjetin kompjuterik për çështje të sigurisë dhe raporton çdo aktivitet të dyshimtë.
- Ndihmon në monitorimin dhe analizimin fillestar të alarmeve të sigurisë (p.sh. nga SIEM), dhe i eskalon ato tek analistët më të lartë.
- Rishikon raportet e dobësive dhe ndihmon në dokumentimin e tyre.
- Ndihmon në realizimin e skanimeve të dobësive sipas planeve të përcaktuara.
- Merr pjesë në hetimin e incidenteve të sigurisë duke ofruar mbështetje teknike dhe duke ndjekur udhëzimet e ekipit.
- Dokumenton incidentet e sigurisë dhe aktivitetet e kryera në mënyrë të saktë dhe të strukturuar.
- Punon me ekipin për të testuar sistemet dhe për të identifikuar dobësitë bazë.
- Ndihmon në implementimin e masave për përmirësimin e sigurisë
- Mbështet aktivitetet e vetëdijesimit për sigurinë e informacionit (trajtime, komunikime, etj.).
- Qëndron i azhurnuar me konceptet bazë të sigurisë kibernetike dhe praktikatat më të mira.
- Kryen detyra të tjera sipas kërkesës së udhëheqësit.

Njohuritë akademike dhe profesionale të kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo matematikës ose një nga certifikimet e mëposhtme:
 - Certified Ethical Hacker (CEH);
 - CompTIA Security+ ;
- Certifikime të tjera relevante ndërkombëtare në fushës e SOC Analyst (Security Operations Center)

Përvoja profesionale e kërkuar:

- Të ketë së paku një vit përvojë në fushën e sigurisë kibernetike

Kërkesat e posaçme:

- Njohuri bazë në rrjete (TCP/IP, DNS)
- Njohuri bazë në siguri (firewalls, antivirus, SIEM)
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së** gjatë aplikimit online nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të bashkëngjisin **letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur posaçërisht **për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- Dëshmi mbi përvojën e punës**, që mbulojnë **së paku një (1) vit** përvojë pune (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, që mbulon **së paku një (1) vit** përvojë pune, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **15 prill 20226**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



KONKURS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Pozicija:	Mladi/a analitiçar/ka sajber bezbednosti
Stepen:	P07
Trajanje zaposlenja:	Na neodređeno vreme
Odeljenje:	Informacione tehnologije i bezbednosti
Odsek:	Sajber bezbednosti i kontinuiteta
Izveštava:	Rukovodiocu Odseka za sajber bezbednost i kontinuitet

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže u podešavanju i održavanju osnovnih sistema i alata za bezbednost informacija pod nadzorom.
- Prati računarsku mrežu zbog bezbednosnih problema i prijavljuje svaku sumnjivu aktivnost.
- Pomaže u početnom praćenju i analizi bezbednosnih alarma (npr. od SIEM-a) i prosleđuje ih višim analitičarima.
- Pregleda izveštaje o slabostima i pomaže u njihovoj dokumentaciji.
- Pomaže u sprovođenju skeniranja slabosti prema utvrđenim planovima.
- Učestvuje u istrazi bezbednosnih incidenata pružanjem tehničke podrške i praćenjem uputstava tima.
- Dokumentuje bezbednosne incidente i sprovedene aktivnosti na tačan i strukturiran način.
- Sarađuje sa timom na testiranju sistema i identifikaciji osnovnih slabosti.
- Pomaže u primeni mera za unapređenje bezbednosti.
- Podržava aktivnosti podizanja svesti o bezbednosti informacija (obuka, komunikacija itd.).
- Ostaje ažuriran sa osnovnim konceptima sajber bezbednosti i najboljim praksama.
- Obavlja i druge dužnosti na zahtev rukovodioca.

Potrebno akademsko znanje i stručna sprema:

- Univerzitetska diploma iz računarskih nauka, elektrotehnike ili matematike ili jedan od sledećih sertifikata:
 - Certified Ethical Hacker(CEH);
 - CompTIA Security+ ;
- Ostali relevantni međunarodni sertifikati u oblasti SOC Analyst (Security Operations Center)

Potrebno stručno iskustvo:

- Da ima najmanje godinu dana iskustva u oblasti sajber bezbednosti.

Posebni zahtevi:

- Osnovno znanje o mrežama (TCP/IP, DNS)
- Osnovno znanje o bezbednosti (firewalls, antivirus, SIEM)
- Znanje engleskog jezika je prednost.

Svi kandidati treba da dostave sledeća dokumenta:

- Prijave koje nisu u potpunosti i ispravno popunjene na **Zvanični obrazac CBK-a** tokom onlajn podnošenje prijave, neće biti razmatrane i rezultiraće diskvalifikacijom tokom procesa selekcije.
- Kandidati treba da prilože **propratno (motivaciono) pismo**, koje treba da bude adresirano i pripremljeno posebno **za poziciju za koju podnose prijavu**; u suprotnom, prijava neće biti razmatrana;
- Dokazi o radnom iskustvu**, koji pokrivaju **najmanje jednu (1) godinu radnog iskustva** (kopije ugovora o radu, potvrde od poslodavca ili drugi relevantni dokumenti kojima se dokazuje rad na toj poziciji i radno iskustvo, bez ugrožavanja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka).
- Izveštaj iz Kosovskog penzionog štednog fonda (Trusta)** za relevantni period, koji pokriva **najmanje jednu (1) godinu** radnog iskustva, ili, u slučajevima kada izveštaj iz Trusta nije zakonski primenljiv, poresku potvrdu iz Poreske administracije Kosova (PAK);
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo treba da budu službeno priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak podnošenja prijave:

- Rok za podnošenje prijave je **15. april 20226. godine**.
- Podnošenje prijave može se vršiti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a. Ostali oblici podnošenja prijave neće biti razmatrani.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L